

Intervistë me

Vanço Shahpaski

Kryedispeçer në NDC

Një ditë me ekipet në terren dhe departamentin e linjave të transmetimit.

Aty ku rruga përfundon, puna vazhdon





AKTUALITETE - 4

INTERVISTË - 10

PROJEKTE -15

STACIONI I TRANSFORMUESIT - 21

GRATË NË ENERGJETIKË – 24

NJË DITË ME EKIPIET NË TERREN DHE DEPARTAMENTIN
E LINJAVE TË TRANSMETIMIT - 27

BURIMET NJERËZORE- 31

KONFERENCA, PREZANTIME, TRAJNIME- 33

ORGANIZATA SINDIKALE E SHA MEPSO- 38

PUNONJËSIT DHE MEPSO - 40

Botuar nga Sha MEPSO

Rruga Maksim Gorki nr.4. Shkup
Republika e Maqedonise se Veriut
www.mepso.com.mk

Drejtori Gjeneral:

Prof. d-r Burim Latifi

Pergatitja teknike:

Irina Daskallovska Qosevska
Violeta Z. Stojanovska
Emine Abazi Gashi
Selvije Ramani


AKTUALITETE

NIVELI I ULËT I UJIT GODITI CENTRALAT BËRTHAMORE, HIDROCENTRALET DHE TRANSPORTIN

Valët ekstreme të të nxehtit dhe thatësira e zgjatur që këtë verë përfshinë Evropën treguan efektet që ndryshimet klimatike kanë mbi sektorin energjetik. Nivelet rekord të ulëta të ujit në Danub, Rajnë, Savë dhe lumenj të tjerë të mëdhenj nuk prekën vetëm transportin lumor dhe bujqësinë, por krijuan një sërë sfidash edhe për prodhimin e energjisë elektrike. Për shkak të mungesës së reshjeve, kapacitetet e disa centraleve bërthamore dhe hidrocentraleve janë zvogëluar, ndërsa qeveritë e disa shteteve kanë marrë masa emergjente për ruajtjen e stabilitetit të sistemit elektroenergjetik.



Gjendja më kritike është në lumin Danub, ku niveli i ulët i ujit po shkakton një sërë problemesh. Në Hungari, centrali bërthamor "Paks" po punon me kapacitet të ndjeshëm të reduktuar për shkak të prurjes së ulët të ujit të nevojshëm për ftohjen e reaktorëve.



Qeveria u bëri thirrje qytetarëve dhe kompanive që ta përdorin energjinë elektrike në mënyrë racionale.



Serioziteti i krizës ilustruhet më së miri në Rumani. Për të siguruar ujë të mjaftueshëm për centralin bërthamor "Cernavoda", u ndërmorën ndërhyrje inxhinierike të papara deri më tani, të cilat përfshinë zhytjen e digave dhe shpërthime të kontrolluara për thellimin e kanaleve lumore. Për shkak të temperaturave të larta dhe prurjes së reduktuar të lumit Sava, në Slloveni, për herë të parë pas dy dekadash, centrali bërthamor "Krško" e uli përkohësisht prodhimin. Kroacia po ashtu ka regjistruar probleme me transportin lumor. Nivelet historikisht të ulëta të ujit në Danub dhe Dravë pothuajse e paralizuan plotësisht lundrimin, ndaj disa anije mallrash mbetën të bllokuara, ndërsa transporti i mallrave u ngadalësua ndjeshëm.

AKTUALITETE

Në Serbi, niveli i ulët i ujit në Danub ndikoi në prodhimin e energjisë në hidrocentralet, ndërsa transporti lumor është vështirësuar ndjeshëm. Prodhimi i reduktuar i energjisë elektrike rrit nevojën për import gjatë periudhave kur kërkesa është më e lartë.



Ndryshe nga fqinjët, Bullgaria po ruan stabilitetin e sektorit të saj bërthamor. Centrali "Kozloduj" vazhdoi të funksionojë pa kufizime të rëndësishme, falë zgjidhjeve teknike që mundësojnë funksionimin e sigurt edhe në kushte të niveleve shumë të ulëta të ujit në Danub. Në këtë krizë, Bullgaria është ndër eksportuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në Evropën Juglindore dhe luan një rol të rëndësishëm në stabilizimin e tregut rajonal..



Pasojat e thatësirës janë të dukshme edhe në Evropën Perëndimore. Lumi Rajnë, një nga arteriet më të rëndësishme të transportit, arriti nivele jashtëzakonisht të ulëta të ujit, për shkak të të cilave anijet lundronin me ngarkesë të reduktuar ndjeshëm, ndërsa një pjesë e transportit u devijua drejt transportit hekurudhor dhe rrugor. Kjo rriti kostot dhe krijoi presion shtesë mbi industrinë dhe zinxhirin e furnizimit.

Kriza e kësaj vere tregoi se ndryshimet klimatike nuk janë më vetëm një sfidë mjedisore, por një faktor serioz që përcakton sigurinë energjetike dhe stabilitetin ekonomik të Evropës. Thatësira nxori në pah dobësitë e sistemeve që varen nga uji dhe



theksoi nevojën për investime më të mëdha në burimet e rinovueshme të energjisë, sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë dhe përmirësimin e lidhjeve ndërkufitare të rrjeteve elektroenergjetike.



Nëse temperaturat e larta dhe mungesa e reshjeve bëhen dukuri gjithnjë e më të shpeshta, vendet evropiane mund të përballen me kufizime shtesë në prodhimin e energjisë elektrike, çmime më të larta të energjisë dhe ndërprerje të reja në transport dhe furnizim.

<https://www.energetika-net.com/energetske-gospodarstvo/ne-krsko-veceras-pocinje-smanjivati-snagu-elektrane>

https://www.dw.com/sr/evropske-nuklearke-na-udaru-ekstremnih-vru%C4%87ina/a-78262526?maca=ser-VEU_Volltext_ser_timemk-43139-xml-media

<https://balkangreenenergynews.com/rs/>

AKTUALITETE**MAQEDONIA SHMANGI KRIZËN ENERGETIKE NË RAJON,
POR THATËSIRA MBETET SFIDË**

Ndërsa shumica e vendeve evropiane u përballën me probleme serioze në sektorin energjetik për shkak të niveleve rekord të ulëta të lumenjve, Maqedonia e kaloi periudhën e të nxehtit pa çrregullime të konsiderueshme në prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike.

Gjendja e favorshme hidrologjike dhe niveli i kënaqshëm i ujit në akumulacionet mundësuan stabilitetin e sistemit energjetik. Ndryshe nga masat e jashtëzakonshme që disa vende evropiane u detyruan të ndërmarrin, Maqedonia nuk pati nevojë për kufizime të ngjashme. Sipas vlerësimeve hidrologjike, reshjet dimërore të borës dhe shiut, si edhe pranvera e lagësht, kontribuan në mbushjen më të mirë të liqeneve dhe akumulacioneve, si dhe në prurje të qëndrueshme drejt hidrocentraleve. Kjo krijoi kushte më të favorshme për prodhimin e energjisë elektrike dhe mundësoi shfrytëzimin e ujit edhe për nevojat tjera, veçanërisht në bujqësi.



Kjo situatë pati ndikim pozitiv edhe në punën e kompanive energjetike. Sipas vlerësimeve të SHA ESM, akumulacionet disponojnë sasi të mjaftueshme uji, gjë që mundëson realizimin e prodhimit të planifikuar të energjisë elektrike. Hidrocentralet, përveç prodhimit, vazhdojnë të ofrojnë edhe shërbime sistimore për ruajtjen e stabilitetit të rrjetit elektroenergjetik. Megjithatë, përvojat nga rajoni tregojnë se një sezon i qëndrueshëm energjetik nuk është garanci për të ardhmen.

Ndryshimet klimatike sjellin periudha gjithnjë e më të shpeshta me temperatura ekstreme, thatësira të zgjatura dhe prurje të reduktuara në lumenj, gjë që mund të çojë në uljen e prodhimit të

hidrocentraleve, ndërsa nga ana tjetër rrit konsumin e energjisë elektrike për ftohje.



Përveç sektorit energjetik, thatësira e zgjatur mund të ushtrojë presion edhe mbi furnizimin me ujë. Verën e kaluar, Shkupi u përball me një ulje të kapacitetit të burimit Rashçe, duke treguar se menaxhimi i burimeve ujore nuk është vetëm çështje mjedisore, por edhe infrastrukturore dhe e sigurisë.

Ekspertët janë të një mendimi se, krahas menaxhimit më të mirë të akumulacioneve, Maqedonia duhet të vazhdojë diversifikimin e burimeve energjetike. Centralet diellore, përmirësimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, mundësitë për ruajtjen e energjisë dhe rritja e ndërlidhjes rajonale mund ta bëjnë sistemin më të qëndrueshëm ndaj ekstremeve klimatike. Mesazhi është i qartë: aktualisht nuk ka rrezik të menjëhershëm për mungesë të energjisë elektrike, por përvojat nga Evropa tregojnë se ndryshimet klimatike do të ndikojnë gjithnjë e më shumë në mënyrën se si shtetet planifikojnë dhe zhvillojnë sistemet e tyre energjetike.



AKTUALITETE**U REALIZUA ME SUKSES TESTIMI I FOTOCENTRALIT "NOVACI" NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT TEKNIKE TË MEPSO-S**

Në fotocentralin "Novaci" u realizua testimi i përputhshmërisë së funksionimit të këtij kapaciteti prodhues me kërkesat dhe kushtet teknike të përcaktuara nga SHA MEPSO. Testimi u zhvillua në përputhje me Protokollin e testimit, në praninë e përfaqësuesve të SHA MEPSO, të cilët monitoruan zhvillimin e të gjitha kontrolleve të planifikuara dhe përputhshmërinë e tyre me procedurat e përcaktuara. Në kuadër të testimit u kryen testi i

shkëputjes dhe sinkronizimit me rrjetin e transmetimit, testet për kontrollin e fuqisë aktive dhe shpejtësisë së ndryshimit të fuqisë aktive (ramp rate), si dhe testet për rregullimin automatik të tensionit, rregullimin automatik të fuqisë reaktive, rregullimin automatik të faktorit të fuqisë dhe verifikimin e kapaciteteve reaktive të parkut energjetik. Prania e inxhinierëve të MEPSO-s mundësoi monitorim të drejtpërdrejtë të realizimit të testeve dhe konfirmimin se ato u zhvilluan në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara. Pas përfundimit me sukses të të gjitha verifikimeve dhe analizës së rezultateve të marra, u lëshua urdhri për përfundimin e testeve dhe vazhdimin e funksionimit të rregullt të objektit prodhues. Aktivitete të tilla përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procesit të verifikimit të kërkesave teknike për kyçjen dhe funksionimin e kapaciteteve prodhuese në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. Përmes tyre sigurohet funksionim i sigurt, i qëndrueshëm dhe i besueshëm i rrjetit elektroenergjetik, në përputhje me standardet dhe kërkesat teknike në fuqi.

APEL PËR BUJQIT PËR SIGURI NË AFËRSI TË LINJAVE TË TENSIONIT TË LARTË

MEPSO u bën thirrje bujqve të tregojnë kujdes të veçantë gjatë kryerjes së aktiviteteve pranë linjave të tensionit të lartë, veçanërisht gjatë periudhës së ujitjes dhe korrjes. Rekomandohet të mos përdoret mekanizim bujqësor, sisteme ujitjeje dhe tuba

metalikë brenda korridoreve mbrojtëse të linjave të transmetimit, si dhe të mos digjen mbetjet bimore në afërsi të tyre. Respektimi i rregullave të sigurisë është thelbësor për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

AKTUALITETE

MEPSO ZGJERON BASHKËPUNIMIN ME JAO EDHE NË KUFIRIN MAQEDONIA E VERIUT- GREQI




Deisa muaj pasi MEPSO u bë pjesë e familjes së JAO – Platformës së vetme të alokimit të Bashkimit Evropian – dhe pas fillimit të suksesshëm të alokimit të kapaciteteve ndërkufitare përmes ankandeve afatgjata dhe ditore në kufirin me Serbinë dhe Bullgarinë, MEPSO është gati ta zgjerojë bashkëpunimin me këtë platformë evropiane. Ekipi i Departamentit për menaxhimin operativ të sistemit elektroenergjetik (OESS), i cili vitin e kaluar realizoi me sukses integrimin e kufijve me Serbinë dhe Bullgarinë, është rikthyer në një proces të ri integrimi.

Në koordinim me përfaqësuesit e operatorit grek të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, janë përfunduar me sukses negociatat për integrimin e kufirit Maqedoni e Veriut–Greqi në platformën JAO dhe kanë nisur përgatitjet për integrimin e plotë funksional në sistemin e alokimit të kapaciteteve.

Përgatitjet janë në zhvillim e sipër, ndërsa takimet e punës ndërmjet JAO dhe operatorëve të sistemeve zhvillohen çdo dy javë. Aktualisht po finalizohen detajet teknike dhe, nëse procesi zhvillohet sipas dinamikës së planifikuar, gjatë muajit shtator i gjithë dokumentacioni do t'i dorëzohet Komisionit Rregullator për Energjetikë, Shërbime të Ujit dhe Shërbime për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale për miratim. Kjo do të thotë se, nga 1 janari 2027, alokimet afatgjata (vjetore dhe mujore), si dhe alokimet afatshkurtra

(ditore), përveç kufijve me Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Serbisë, do të realizohen nga JAO edhe në kufirin Maqedonia e Veriut–Greqi.

JAO, me seli në Luksemburg, është Platforma e vetme e alokimit të Bashkimit Evropian dhe platforma e vetme evropiane e njohur nga ENTSO-E për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare. JAO është një kompani shërbimi që menaxhon platformën kryesore evropiane të tregtimit (e-CAT) për kapacitetet ndërkufitare të transmetimit. Në emër të operatorëve të sistemeve të transmetimit (TSO), JAO organizon ankandet për të drejtat afatgjata dhe afatshkurtra të kapaciteteve të transmetimit në të gjitha kufijtë e brendshëm të Bashkimit Evropian.



Source: ACER.

Përveç kësaj, JAO organizon edhe ankande rezervë ("shadow auctions"), të cilat shërbejnë si mekanizëm alternativ në rast të ndërprerjeve të funksionimit të tregut të përbashkët ditor (SDAC). Që nga 1 tetori 2018, JAO funksionon si Platforma e vetme e alokimit (SAP) për të gjithë operatorët evropianë të sistemeve të transmetimit që veprojnë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke përbushur të gjitha detyrimet dhe kërkesat rregullatore. Integrimi i kufirit Maqedonia e Veriut–Greqi në sistemin e JAO përbush edhe një kusht të rëndësishëm për bashkimin e tregut maqedonas të energjisë elektrike me tregun grek të energjisë elektrike.

AKTUALITETE**SIGUARIA E LARGPËRÇUESVE FILLON NE TERREN**

Shërbimi për mirëmbajtjen e korridoreve, si pjesë e Departamentit për mirëmbajtjen e largpërçuesve, është përgjegjës për prerjen dhe largimin e vegjetacionit të rritur brenda korridoreve të përcaktuara të sigurisë së largpërçuesve në pronësi të ShA MEPSO.



Aktivitetet realizohen në bazë të dokumentacionit planifikues, i cili përgatitet në përputhje me raportet nga inspektimet vizuale të kryera nga ekipet e Departamentit të largpërçuesve. Të gjithë punëtorët e angazhuar për prerjen e vegjetacionit posedojnë certifikata për përfundimin me sukses të trajnimit për punë të sigurt me sharrë motorike. Ata janë të pajisur edhe me pajisje përkatëse personale mbrojtëse për punë gjatë prerjes, të cilat përfshijnë pantallona mbrojtëse me kevlar, pallto mbrojtëse, doreza me kevlar, helmetë mbrojtëse me vizor dhe mbrojtëse për dëgjimin.

Ekipet e angazhuara për mirëmbajtjen e korridoreve janë pjesë përbërëse e ekipeve të largpërçuesve dhe

janë të shpërndara në TS Shkup 1, TS Shtip, TS Manastir dhe TS Ohër. Pjesa më e madhe e aktiviteteve për prerjen e vegjetacionit kryhet ndërkohë që linjat e transmetimit janë nën tension, duke zbatuar procedurat dhe masat përkatëse të sigurisë për mbrojtjen e punëtorëve dhe infrastrukturës elektroenergjetike. Në rastet kur nevojitet prerja e trungjeve me përmasa më të mëdha, ku ekziston rreziku që gjatë prerjes trugu të bjerë në drejtim të përçuesve, zbatohet shkyçja parandaluese e largpërçuesve.



Gjithashtu, në varësi të kushteve konkrete në terren, ndërmerren edhe masa të tjera të sigurisë, si sigurimi dhe lidhja e pjesës së sipërme të trungut, tërheqja e kontrolluar e tij në drejtimin e parashikuar të rënies, si dhe masa të tjera përkatëse për realizimin e sigurt të punës. Në këtë mënyrë sigurohet mirëmbajtja e pandërprerë e korridoreve të sigurisë, zvogëlohet rreziku i kontaktit ose afrimit të vegjetacionit me përçuesit dhe krijohen kushte për funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjetit të transmetimit.



INTERVISTË ME VANÇO SHAHPASKI, KRYEDISPENÇER NË QNK

BALANCI I SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK MBAHET ME DIJE, TEKNOLOGJI DHE VENDIME TË SHPEJTA



Qendra Nacional e Dispeçerisë (QND) e MEPSO-s është vendi nga ku monitorohet dhe menaxhohet në kohë reale sistemi elektroenergjetik i transmetimit të Maqedonisë së Veriut. Vendimet që merren në QND janë thelbësore për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike, ruajtjen e stabilitetit të rrjetit dhe koordinimin me operatorët evropianë të sistemeve të transmetimit. Në një bisedë me kryedispeçerin e MEPSO-s, inxhinierin e diplomuar të elektroteknikës Vanço Shahpaski, flasim për përgjegjësinë që mbart kjo pozitë, ndryshimet që sjellin burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe digjitalizimi, rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, si dhe sfidat me të cilat përballen sot operatorët e sistemeve të transmetimit.

Çfarë do të thotë të jesh kryedispeçer në sistemin nacional të transmetimit të energjisë elektrike dhe cilat janë përgjegjësitë tuaja kryesore?

Nëse rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike përfaqëson sistemin e qarkullimit të gjakut të sistemit elektroenergjetik, atëherë Qendra Kombëtare e Dispeçerisë përfaqëson trurin e këtij sistemi. QND, si pjesë e infrastrukturës strategjike

dhe kritike të një sistemi elektroenergjetik, përbëhet nga disa sektorë që funksionojnë si një tërësi. Përveç dispeçerëve, roli i të cilëve është të drejtojnë sistemin elektroenergjetik, këtu bëjnë pjesë edhe departamentet që planifikojnë dhe përgatisin funksionimin e sistemit nga aspekti i analizave të tregut dhe sigurisë, departamentet që përmbledhin, analizojnë dhe vlerësojnë funksionimin e sistemit, si dhe departamentet që, në prapavijë, kujdesen për të gjitha programet, aplikacionet dhe pajisjet harduerike, me qëllim që të sigurohet funksionimi i pandërprerë i

QND-së. Kjo mundëson furnizim cilësor dhe të sigurt me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, si dhe tranzit të pandërprerë të energjisë përmes linjave interkonektive, duke siguruar dërgimin e të dhënave të sakta nga të gjithë elementët e rrjetit të transmetimit drejt Qendrës Nacionale të Dispeçerisë. Roli i kryedispeçerit është të koordinojë punën e të gjitha departamenteve të përmendura, të krijojë dhe të ruajë koordinimin ndërmjet tyre, me një qëllim të vetëm: të sigurojë funksionimin e pandërprerë dhe të sigurt të sistemit elektroenergjetik, furnizim cilësor dhe të besueshëm me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, si dhe tranzit të vazhdueshëm të energjisë nëpërmjet linjave interkonektive. Me pak fjalë, të punosh si kryedispeçer do të thotë të kujdesesh 24 orë në ditë që sistemi të funksionojë në mënyrë të sigurt dhe stabile. Çdo vendim që marrim mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në furnizimin me energji elektrike në të gjithë vendin.

Si ka ndryshuar puna e dispeçerit në vitet e fundit dhe cilat teknologji kanë ndikuar më së shumti në menaxhimin e sistemit?

Nëse analizojmë një periudhë më të gjatë kohore, mund të themi se roli i dispeçerit nuk ka ndryshuar – ai vazhdon të jetë siguri i funksionimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik. Megjithatë, mënyra se si menaxhohet sistemi ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Nga njëra anë, nevoja në rritje për përdorimin e mjeteve të ndryshme softuerike, aplikacioneve, llogaritjeve dhe analizave ka digjitalizuar menaxhimin e sistemit elektroenergjetik, duke e bërë atë më të shpejtë dhe më efikas. Nga ana tjetër, integrimi gjithnjë e më i madh i prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, si dhe i konsumatorëve me profile jo standarde të konsumit, e bën menaxhimin e sistemit më kompleks dhe më pak të parashikueshëm. Për këtë arsye, është shfaqur nevoja për planifikim më të saktë të funksionimit të sistemit dhe të aktiviteteve të të gjithë përdoruesve të rrjetit të transmetimit. Një rol kyç luan edhe shkëmbimi i shpejtë i të dhënave, i cili është i domosdoshëm për planifikimin dhe parashikimin e funksionimit të pjesëve të veçanta të sistemit, por edhe të sistemit në tërësi. Për ta përmbledhur, puna e dispeçerit është jashtëzakonisht e përgjegjshme dhe dinamike, duke u zhvilluar vazhdimisht. Me avancimin dhe zbatimin e inteligjencës artificiale, kjo punë do të vazhdojë të transformohet dhe të përshtatet me trendet dhe kërkesat e reja teknologjike.



Cilat janë parametrat kryesorë që monitoroni në kohë reale për të siguruar një menaxhim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit?

Funksionimi i sigurt dhe i qëndrueshëm i sistemit elektroenergjetik nënkupton që vlerat e parametrave kryesorë të jenë brenda kufijve të lejuar. Roli i dispeçerit është t'i monitorojë

vazhdimisht këta parametra dhe, në rast të devijimeve, të ndërmarrë masat e nevojshme për t'i rikthyer brenda vlerave të përcaktuara. Në kohë reale monitorohen: frekuenca e sistemit, gabimi i zonës së kontrollit, përkatësisht devijimi nga prodhimi, konsumi dhe shkëmbimi i planifikuar i energjisë elektrike, si dhe krahasimi i tyre me vlerat reale të matura në atë moment; ngarkesa e linjave të transmetimit dhe e transformatorëve; prodhimi dhe konsumi aktual i energjisë elektrike; flukset ndërkufitare të energjisë, si edhe një sërë parametrash të tjerë të domosdoshëm për furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike.



Në cilat situata dispeçerët duhet të reagojnë me shpejtësi?

Shpejtësia dhe efikasiteti në përballimin e situatave të paparashikuara janë tregues të profesionalizmit dhe aftësisë së një dispeçeri. Në shumicën e rasteve, situatat e paparashikuara në menaxhimin e sistemit elektroenergjetik lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me kushtet meteorologjike, defektet e pajisjeve, si edhe me ndryshimet e papritura në prodhimin e energjisë elektrike dhe në kapacitetet prodhuese. Shkaqet mund të jenë teknike, natyrore ose, në raste të caktuara, pasojë e faktorëve njerëzorë. Roli i dispeçerit është të menaxhojë situatën e krijuar dhe, në kohën më të shkurtër të mundshme, ta rikthejë sistemin ose një pjesë të tij në regjim normal dhe të sigurt pune, duke garantuar furnizim të pandërprerë me energji elektrike. Shembulli më i fundit është moti i keq që përfshiu Maqedoninë e Veriut në fund të muajit korrik. Dispeçerët e turnit e menaxhuan situatën me profesionalizëm dhe në një kohë shumë të shkurtër u rikthye furnizimi me

energji elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit.

Si duket një situatë krize në Qendrën Nacionale të Dispeçerisë? Sa kohë ka dispeçeri për të reaguar dhe çfarë është vendimtare në ato momente – procedurat, përvoja apo cilësitë e tij personale?

Shembulli më i mirë, por edhe testi më i mirë për shpejtësinë e reagimit, aftësinë për t'u përballur me situata të paparashikuara dhe mobilizimin e të gjithë ekipit të dispeçerisë, ishte incidenti i vitit të kaluar në sistemin elektroenergjetik. Për shkak të tensioneve jashtëzakonisht të larta në rrjetin 400 kV, u shkëputën nga puna të gjithë transformatorët energjetikë të lidhur në këtë rrjet, ndërsa rrjetet 400 kV dhe 110 kV u ndanë nga njëri-tjetri. Si pasojë, një pjesë e madhe e zonës së konsumit mbeti pa furnizim me energji elektrike. Në situata të tilla, vendimtare është ndërthurja e njohjes së thellë të procedurave me përvojën shumëvjeçare në operimin e sistemit elektroenergjetik. Dispeçeri duhet të mbetet i qetë, të gjykojë me kthjelltësi, të mos lejojë që paniku ta dominojë dhe të përqendrohet maksimalisht në situatën e krijuar. Vetëm përmes një vlerësimi të saktë dhe vendimeve të marra në kohë mund të menaxhohet sistemi në mënyrë të sigurt dhe të sigurohet rikthimi i tij i shpejtë në regjimin normal të punës.



Si e ka ndryshuar punën e dispeçerit rritja e pjesëmarrjes së centraleve diellore dhe të erës?

Integrimi i prodhuesve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, veçanërisht i centraleve fotovoltaike dhe atyre me erë, sjell ndryshueshmëri më të madhe në sistem dhe luhet më të mëdha, shpesh të paplanifikuara, të parametrave që janë

thelbësorë për menaxhimin e sistemit, pasi prodhimi i tyre varet drejtpërdrejt nga kushtet meteorologjike. Për këtë arsye nevojiten parashikime më të sakta, fleksibilitet më i madh i sistemit, monitorim i vazhdueshëm i balancës ndërmjet prodhimit dhe konsumit, si dhe një treg i zhvilluar mirë i shërbimeve balancuese. Në të njëjtën kohë, integrimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë është një element i domosdoshëm i tranzicionit energjetik dhe përfaqëson një mundësi për ndërtimin e një sektori energjetik më modern, më efikas dhe më të qëndrueshëm.


Sa i rëndësishëm është parashikimi i saktë i prodhimit dhe konsumit për menaxhimin e sigurt të sistemit?

Parashikimi është një nga mjetet më të rëndësishme për menaxhimin e sigurt të sistemit. Sa më të sakta të jenë parashikimet për konsumin dhe prodhimin e energjisë elektrike, aq më mirë mund të planifikohen rezervat dhe kapacitetet ndërkufitare. Siguria operative e sistemit elektroenergjetik sigurohet përmes mbledhjes dhe analizës së parashikimeve të konsumit dhe prodhimit nga të gjithë përdoruesit e sistemit elektroenergjetik, me qëllim identifikimin paraprak të çrregullimeve të mundshme, reagimin në kohë për zvogëlimin e disbalancave të sistemit, si dhe ndërmarrjen e masave parandaluese në rast të devijimeve të mundshme të parametrave të sistemit. Në punën tonë përdorim modele të ndryshme analitike, të dhëna meteorologjike dhe mjete të specializuara softuerike për hartimin e parashikimeve afatshkurtra dhe afatmesme..

Sistemi elektroenergjetik i Maqedonisë së Veriut është pjesë e rrjetit sinkron kontinental evropian. Pse është i rëndësishëm koordinimi i përditshëm me operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit?

Sot, asnjë sistem elektroenergjetik nuk funksionon i izoluar. Të gjitha sistemet e transmetimit të energjisë elektrike në Evropën kontinentale janë të ndërlidhura dhe çdo çrregullim në funksionimin e një sistemi reflektohet më së shumti te sistemet e lidhura drejtpërdrejt, por mund të ndikojë edhe në të gjithë rrjetin kontinental evropian. Objektivi afatgjatë i ENTSO-E është që i gjithë rrjeti evropian

i transmetimit të energjisë elektrike të funksionojë si një supersistem i vetëm, i menaxhuar nga një qendër e vetme dhe disa qendra rajonale koordinuese, të cilat në të ardhmen do të zëvendësojnë qendrat aktuale rajonale për llogaritjet e sigurisë. Për më tepër, bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike në Evropë synon të mundësojë që energjia e prodhuar në një pjesë të kontinentit të transportohet deri në skajin tjetër të tij. Kjo do të thotë se energjia duhet të kalojë përmes rrjeteve të transmetimit të disa shteteve. Për ta bërë këtë të mundur, nevojitet koordinim i vazhdueshëm i flukseve të energjisë, i konfigurimit të elementeve të sistemit elektroenergjetik, si dhe kryerja e analizave operative të sigurisë mbi një model të përbashkët që përfshin të gjithë operatorët e sistemeve të transmetimit. Për shembull, dalja jashtë funksionit e një elementi të rëndësishëm në një shtet mund të shkaktojë ridrejtimin e flukseve të energjisë përmes disa sistemeve fqinje. Për këtë arsye, ne komunikojmë çdo ditë me operatorët e rajonit dhe koordinojmë së bashku regjimet e punës dhe ndërprerjet e planifikuara.



Cilat zgjidhje digjitale e kanë avancuar më së shumti punën e Qendrës Kombëtare të Dispeçerisë?

Sektori energjetik, e veçanërisht menaxhimi i sistemit elektroenergjetik, prej vitesh përfiton nga avantazhet që sjellin digjitalizimi dhe automatizimi. Kohët e fundit, një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e menaxhimit po merr edhe inteligjenca artificiale. Mjetet kryesore për operimin e sistemit elektroenergjetik janë sistemi SCADA, aplikacioni për menaxhimin e tregut MMS dhe aplikacioni AMR/MDM për llogaritjen dhe përpunimin e të dhënave mbi energjinë e dorëzuar

dhe të pranuar. Këto janë sisteme pa të cilat menaxhimi i sistemit elektroenergjetik nuk do të ishte i mundur dhe që vazhdimisht përmirësohen dhe zhvillohen. Në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit. Gjithashtu, është rritur numri i nënstacioneve transformuese që mund të monitorohen dhe të menaxhohen nga distanca, ndërsa përdoren edhe aplikacione të reja që automatizojnë procese të ndryshme në sistemin elektroenergjetik. Në përdorim janë gjithashtu programe për parashikime operative dhe simulime të tregut, sisteme për menaxhimin e ngjarjeve, si dhe platforma të ndryshme për shkëmbimin e të dhënave.

Cilat janë sfidat më të mëdha për operatorët e sistemeve të transmetimit në Evropë, sot dhe në dekadën e ardhshme??

Çdo profesion ka rreziqet e veta, por pasojat mund të jenë shumë të ndryshme. Rreziqet teknike që lidhen me kushtet ekstreme atmosferike janë pjesë e përditshme e menaxhimit të sistemit elektroenergjetik.

Integrimi i një sasive gjithnjë e më të madhe të prodhimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, së bashku me ndryshimet klimatike, ka krijuar rreziqe të reja në formën e flukseve të paparashikuara dhe më të mëdha të energjisë, të cilat devijojnë nga modelet tradicionale të qarkullimit të energjisë. Si rezultat, janë shfaqur situata dhe vlera të parametrave të sistemit që deri vonë konsideroheshin të pamundura dhe që tejkalojnë kufijtë e zakonshëm operacionalë.

Të gjitha këto rreziqe teknike janë pjesë përbërëse e operimit të sistemit elektroenergjetik dhe ne duhet të jemi të përgatitur për t'i menaxhuar ato.

Megjithatë, vitet e fundit jemi përballur me një sfidë të re: sulmet kibernetike dhe ruajtja e sigurisë kibernetike. Ky është një rrezik që shkon përtej menaxhimit tradicional të sistemit elektroenergjetik dhe pasojat e tij mund të jenë shumë më serioze dhe më të vështira për t'u parashikuar.

Cili është roli i Maqedonisë së Veriut dhe i MEPSO-s në sistemin rajonal dhe evropian të energjisë elektrike?

Maqedonia e Veriut dhe MEPSO janë pjesë e sistemit elektroenergetik evropian dhe anëtare me të drejta të plota të ENTSO-E për më shumë se 15 vjet. Avantazhi kryesor i vendit është pozita e tij strategjike dhe qendrore në Gadishullin Ballkanik, ndërlidhja e mirë me sistemet fqinje të transmetimit, si dhe investimet e vazhdueshme në ndërtimin e linjave të reja ndërkufitare të transmetimit. Kjo e pozicionon Maqedoninë e Veriut si një nyje të rëndësishme tranziti për energjinë elektrike që lëviz nga lindja dhe jugu drejt veriut dhe perëndimit, si dhe në drejtimin e kundërt. Linjat ndërkufitare të transmetimit me vendet fqinje mundësojnë rrjedhë të pandërprerë të energjisë elektrike, rrisin sigurinë e furnizimit dhe kontribuojnë në funksionimin më efikas të tregut rajonal dhe evropian të energjisë elektrike.



Çfarë nënkuptojnë për MEPSO-n dhe për Maqedoninë e Veriut bashkimi i tregjeve dhe integrimi në tregun evropian të energjisë elektrike?

Bashkimi i tregjeve nënkupton ofertë dhe kërkesë më të madhe për energji elektrike, konkurrencë më të fortë, shfrytëzim më efikas të infrastrukturës dhe përdorim më racional të burimeve në dispozicion. Në praktikë, kur energjia elektrike mund të qarkullojë më lirshëm ndërmjet tregjeve fqinje, përmirësohet siguria e furnizimit dhe krijohen kushte për funksionim më efikas të të gjithë tregut rajonal. Qëllimi përfundimtar i bashkimit të tregjeve është krijimi i një tregu të vetëm evropian të energjisë elektrike. Për MEPSO-n, kjo nënkupton shfrytëzim më efikas të potencialit të plotë të rrjetit të transmetimit, ndërsa për Maqedoninë e Veriut krijon mundësi për qasje të drejtpërdrejtë në tregjet evropiane të energjisë elektrike.



Çfarë kanë mësuar operatorët evropianë nga çrregullimet e mëdha të sistemit në vitet e fundit dhe si ndikojnë këto përvoja në punën e MEPSO-s?

Çrregullimet e mëdha në rrjetet e transmetimit në Evropë kanë dëshmuar se edhe një ngjarje që fillon në një vend mund të përhapet me shpejtësi në shumë sisteme të tjera. Ritmi me të cilin po zhvillohen ndryshimet në sektorin energjetik, veçanërisht integrimi i prodhimit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, është më i shpejtë se ritmi me të cilin operatorët arrijnë të përshtatin mënyrën e menaxhimit të këtyre ndryshimeve. Si pasojë, sot hasim situata që vetëm pak vite më parë konsideroheshin të paimagjinueshme. Për këtë arsye, operatorët i kushtojnë sot edhe më shumë rëndësi shkëmbimit të të dhënave në kohë reale, planifikimit të saktë të flukseve të energjisë dhe kryerjes së analizave të përbashkëta të sigurisë për rajone më të gjera.

Një nga mësimet më të rëndësishme është se pa koordinim rajonal, analiza të përbashkëta dhe



procedura të harmonizuara për menaxhimin e situatave emergjente ndërmjet të gjithë operatorëve të sistemeve të transmetimit në Evropë, nuk mund të ketë një sistem elektroenergetik të sigurt dhe të besueshëm.

PROJEKTE**TS OHËR PO HYN NË FAZËN PËRFUNDIMTARE TË REALIZIMIT**

Ndërtimi i trafostacionit të ri 400 kV Ohër, i cili është pjesë e segmenteve kyçe të interkoneksionit të parë 400 kV ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, po shënon përparim të dukshëm dhe ndodhet në fazën përfundimtare të realizimit. Pas përfundimit të instalimit të pajisjeve primare dhe sekondare, kanë filluar testimet operative-funksionale të sistemeve. Në këtë fazë verifikohet

funksionaliteti, përputhshmëria dhe gatishmëria e pajisjeve dhe sistemeve për funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Aktivitetet në objekt vazhdojnë sipas dinamikës së parashikuar, me qëllim përfundimin e të gjitha punimeve të mbetura dhe përgatitjen për kyçjen e tij në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, pas plotësimit të të gjitha parakushteve për funksionimin e plotë të interkoneksionit. Testimet kryhen nga kontraktori i punimeve, në praninë e ekspertëve të ShA MEPSO, të

angazhuar në grupin e punës për implementimin e projektit.

Trafostacioni i ri 400 kV Ohër do të ketë një rol të rëndësishëm në forcimin e rrjetit të transmetimit, rritjen e sigurtisë së sistemit elektroenergjetik dhe krijimin e një lidhjeje të re energjetike me Shqipërinë.



PROJEKTE**PËRPAROJNË EDHE PUNIMET NDËRTIMORE NË LARGPËRÇUES 400 kV
MANASTIR – ELBASAN**

Në trasenë e largpërçuesit ka filluar montimi, përkatësisht ngritja e shtyllave të para, duke shënuar hyrjen e projektit në një fazë të re të realizimit.

Njëkohësisht, ekipet ndërtimore po punojnë në disa fronte: po sigurohet qasja deri te vendet e shtyllave, po kryhen gërmime dhe betonime të themeleve, ndërsa në disa lokacione përgjatë trasesë po zhvillohen intensivisht aktivitetet përgatitore për vendosjen e shtyllave të reja. Të gjitha këto aktivitete realizohen në seksionin e parë nga dy seksionet e linjës së transmetimit, nga TS Manastir 2 deri te TS i ri Ohër, dhe zhvillohen sipas dinamikës së parashikuar.

Largpërçuesi Manastir–Elbasan përfaqëson segmentin kryesor lidhës të interkoneksionit të ri, i cili do të mundësojë krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë 400 kV me Shqipërinë. Pas përfundimit të projektit, linja e re e transmetimit do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve

ndërkufitare të transmetimit, forcimin e sigurisë së sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e ndërlidhjes energjetike rajonale.



QENDËR E RE REZERVË E TË DHËNAVE NË MEPSO:

BAZË INFRASTRUKTURE PËR QËNDRUESHMËRI MË TË MADHE DHE VAZHDIMËSI TË SISTEMEVE TIK

Përgatitur nga Departamenti i TI-së

Si operator i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ShA MEPSO ka detyrimin të sigurojë nivel të lartë të disponueshmërisë, besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve që mbështesin proceset kryesore operative dhe të biznesit të kompanisë.

Në këtë drejtim u realizua projekti për ngritjen e një Qendre të re rezervë për rikuperimin e të dhënave (Disaster Recovery Data Center) në tafostacionin transformator (TS) Dubrovë, në Negotinë.

Qëllimi kryesor i projektit ishte krijimi i një lokacioni shtesë për vendosjen dhe rikuperimin e sistemeve kritike të informacionit, duke forcuar kapacitetet për vazhdimësinë e biznesit dhe reagimin ndaj situatave të paparashikuara.



Realizimi i projektit përfshiu rregullimin e plotë të hapësirës dhe implementimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e një qendre moderne të të dhënave. U instaluan kabinete IT, sisteme të furnizimit të pandërprerë

me energji (UPS), infrastrukturë elektroenergetike, sisteme të klimatizimit preciz, sistem për zbulimin dhe shuarjen automatike të zjarrit, sistem për kontrollin e qasjes, video-mbikëqyrje, kabllim të strukturuar, si dhe sistem për monitorimin dhe menaxhimin e parametrave teknike të infrastrukturës.

Pas përfundimit të aktiviteteve të instalimit u kryen testime funksionale të të gjitha sistemeve të implementuara, pas së cilave qendra rezervë e të dhënave u vu në përdorim operativ.



Krijimi i lokacionit Disaster Recovery përfaqëson një hap të rëndësishëm në rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të MEPSO-s.

Qendra e re e të dhënave krijon kushte për rikuperim më të shpejtë të sistemeve kritike në rast të mosdisponueshmërisë së infrastrukturës primare dhe paraqet një shtresë shtesë mbrojtjeje për burimet informative të kompanisë.


Gjatë realizimit të projektit u zbatuan parimet e redundancës, sigurisë fizike dhe monitorimit të vazhdueshëm, me qëllim sigurimin e funksionimit



të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të infrastrukturës. Sistemi i centralizuar i monitorimit mundëson kontroll në kohë reale të parametrave kryesorë teknikë, duke përfshirë furnizimin me energji, klimatizimin dhe kushtet ambientale në hapësirë, gjë që mundëson zbulimin në kohë të devijimeve dhe reagim më të shpejtë.

mbështet sistemet informative të kompanisë. Në kuadër të projektit u realizua edhe trajnimi i personelit profesional, me qëllim menaxhimin dhe mirëmbajtjen efikase të infrastrukturës së re..

Me realizimin e projektit për Qendrën e re rezervë të të dhënave, ShA MEPSO fitoi një infrastrukturë moderne, e cila përbën një element të rëndësishëm



Vëmendje e veçantë iu kushtua sigurisë fizike të objektit përmes implementimit të sistemeve për kontrollin e qasjes, video-mbikëqyrjes dhe mbrojtjes automatike kundër zjarrit.

Në këtë mënyrë sigurohet një nivel i lartë mbrojtjeje për pajisjet dhe infrastrukturën që

në garantimin e vazhdimësisë së operimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve digjitale të kompanisë. Ky projekt është një hap tjetër drejt forcimit të qëndrueshmërisë së infrastrukturës kritike dhe sigurimit të mbështetjes së qëndrueshme për proceset që mundësojnë funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

PROJEKTE


STUDIMI MBI ADEKUATSHMËRINË KONFIRMON: SISTEMI ELEKTROENERGJETIK I MAQEDONISË SË VERIUT ËSHTË I PËRGATITUR PËR TRANZICIONIN ENERGJETIK

Shkruan: Sime Kuzarevski, Shërbimi për Pplanifikim strategjik dhe analiza zhvillimore

Vlerësimi i parë kombëtar i adekuatshmërisë së burimeve, i hartuar nga MEPSO në përputhje me metodologjinë evropiane të ENTSO-E (ERAA), konfirmon se sistemi elektroenergjetik i Maqedonisë së Veriut disponon burime të mjaftueshme prodhuese dhe transmetuese për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike në të gjitha horizontet kohore të analizuar.

Ky studim është analiza e parë e këtij lloji në vend dhe në rajon, e realizuar duke zbatuar metodologjinë moderne probabilistike. Me ndihmën e simulatorit të tregut ANTARES, janë modeluar sistemet elektroenergjetike të 34 vendeve evropiane, duke analizuar mbi 37 milionë gjendje të mundshme të ardhshme përmes 720 simulimeve Monte Carlo për secilin skenar dhe horizont planifikimi. Në këtë mënyrë, për herë të parë është bërë e mundur një vlerësim realist i sigurisë së furnizimit në kushtet e ndryshimeve klimatike, integritetit në rritje të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, konsumit të ndryshueshëm dhe integritetit rajonal të tregut.


Rezultatet tregojnë se indikatorët kryesorë LOLE (Loss of Load Expectation) dhe EENS (Expected Energy Not Served), të cilët janë treguesit bazë evropianë për vlerësimin e adekuatshmërisë së burimeve, mbeten dukshëm nën kufirin referues. Kjo do të thotë se nuk pritet mungesë e energjisë elektrike, as në kushte ekstreme atmosferike dhe



as në rast të ndërprerjeve të paplanifikuara të kapaciteteve prodhuese.

Veçanërisht me rëndësi është fakti se edhe skenari me zhvillim më ambicioz të profilit të prodhimit dhe me pjesëmarrje dukshëm më të lartë të centraleve diellore dhe me erë nuk e rrezikon sigurinë e furnizimit të sistemit elektroenergjetik të Maqedonisë së Veriut. Kjo falë kombinimit të kapaciteteve fleksibile vendore të prodhimit, kryesisht centraleve me gaz dhe hidrocentraleve, si dhe nivelit të lartë të ndërlidhjes rajonale dhe interkoneksioneve të shkëlqyera me vendet fqinje.

Horizonti afatmesëm i planifikimit përfaqëson një fazë kyçe të tranzicionit energjetik të vendit, gjatë së cilës pritet mbyllja e plotë e termocentraleve të vjetra me linjit dhe një rritje e ndjeshme e burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Studimi ofron gjithashtu njohuri mbi një nga sfidat më të rëndësishme të së ardhmes – fenomenin që po bëhet gjithnjë e më i dukshëm në Evropë: tepriçen e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (spilled energy).




Energjia e papërdorur nga burimet e ripërtëritshme (spilled energy)

AN Analizat tregojnë se ky fenomen është i pranishëm në të gjithë Evropën, veçanërisht gjatë

.periudhave me prodhim të lartë të energjisë nga centralet diellore dhe me erë dhe me konsum të ulët. Ai shpesh reflektohet përmes çmimeve negative në bursat e energjisë. Në Maqedoninë e Veriut, energjia e papërdorur nga burimet e ripërtëritshme pritet të shfaqet më së shumti gjatë muajve të pranverës, kur konsumi i energjisë është më i ulët. Megjithatë, niveli i saj mbetet dukshëm më i ulët se në vendet e Evropës Perëndimore, falë mundësive për shkëmbim rajonal të energjisë elektrike.

Rezultatet tregojnë se Maqedonia e Veriut ka potencial të pozicionohet si eksportuese rajonale e energjisë së gjelbër, nëse paralelisht vazhdojnë investimet në sistemet e baterive, hidrocentralet me akumulim dhe pompim, mekanizmat për menaxhimin e konsumit dhe forcimin e mëtejshëm të interkoneksioneve ndërkufitare.

Studimi për vlerësimin e adekuatshmërisë përfaqëson një nga analizat më të rëndësishme të përgatitura nga MEPSO në vitet e fundit. I hartuar në bashkëpunim me RTE International dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD), ai përbën bazë strategjike për planifikimin e zhvillimit të ardhshëm të sektorit elektroenergjetik të Maqedonisë së Veriut, integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe garantimin e sigurisë afatgjatë të furnizimit me energji elektrike.



Shpërndarja e energjisë së papërdorur sipas ditëve

PREZANTIMI I STACIONEVE TRANSFORMATORIKE**TS KAVADARCI – MË SHUMË SE GJYSMË SHEKULLI NË SHËRBIT TË FURNIZIMIT TË SIGURT ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Pergatiti: Irina Daskalovska Qosevska



Në zemër të rajonit të Tikveshit, për më shumë se gjysmë shekulli, nënstacioni elektrik Kavadarci përfaqëson një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës elektroenergjetike të vendit. I vënë në funksion në vitin 1968, nënstacioni në fillimet e tij ishte projektuar si një objekt 110/35 kV dhe kishte një rol të rëndësishëm si pikë kyçeje e HEC-it „Tikvesh” me sistemin elektroenergjetik të asaj kohe.



Sot, pas gati gjashtë dekadash funksionimi, TS Kavadarci ka një rëndësi shumë më të gjerë. Ai përfaqëson një nyje të rëndësishme energjetike në rrjetin 110 kV dhe është një nga objektet kyçe për furnizimin e sigurt dhe të qëndrueshëm me energji

elektrike të rajonit. Nëpërmjet lidhjeve të saj, TS Kavadarci është e lidhur me TS Dubrovë, TS Prilep, TS Veles, TS IGM dhe TS Kavadarci – Qytet, e cila përfaqëson burimin kryesor të furnizimit me energji elektrike për qytetin e Kavadarci dhe konsumatorët industrialë të rajonit

„TS Kavadarci nuk është vetëm një objekt me pajisje dhe linja transmetimi. Ky është një objekt nga i cili varen funksionimi i përditshëm i rajonit, industria dhe cilësia e jetës së qytetarëve.

Detyra jonë është që kjo infrastrukturë të jetë e sigurt 24 orë në ditë, 365 ditë në vit”, thotë Slobodan Bogevi, drejtues i TS Kavadarci..

Në përbërje të TS Kavadarci janë edhe TS e re IGM dhe objekti 110 kV i HEC-it „Tikvesh”, gjë që e thekson edhe më tej rolin e saj në stabilitetin dhe

sigurinë e rrjetit elektroenergjetik. Në TS Kavadarci janë instaluar dy transformatorë 110/35 kV, me fuqi prej 20 MVA secili, të destinuar për nevojat e EVN-së. Por pas sigurisë së një objekti të tillë nuk qëndron vetëm fuqia e pajisjeve, por edhe mirëmbajtja e tyre, mbikëqyrja e vazhdueshme dhe profesionalizmi i ekipit që kujdeset për funksionalitetin e tyre.



Gjatë periudhës së kaluar janë realizuar investime të rëndësishme në modernizimin e objektit. Në vitin 2017 u krye rikonstrukcioni i plotë i pajisjeve primare në objektin 110 kV, ndërsa në vitin 2022 u rinovuan pajisjet sekondare, përkatësisht sistemet e komandimit dhe mbrojtjes, me instalimin e sistemit SCADA.




Këto investime mundësuan përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e sigurisë në menaxhimin e objektit dhe mbikëqyrjen më efikase të gjendjes së pajisjeve.

Edhe teknologjia më moderne nuk mund ta zëvendësojë ekspertizën, përgjegjësinë dhe përkushtimin e njerëzve që çdo ditë kujdesen që sistemi të funksionojë në mënyrë të sigurt. Ekipi në TS Kavadarci punon në kushte që kërkojnë profesionalizëm të lartë, përqendrim dhe gatishmëri për reagim në kohë. Veçanërisht e rëndësishme është siguria në punë, që nënkupton zbatimin rigoroz të procedurave dhe rregullave, si dhe respektimin e vazhdueshëm të masave të përcaktuara..

"Vlerësimi më i madh për punën tonë është kur përdoruesit dhe kompanitë nuk e ndiejnë praninë tonë, sepse kjo do të thotë se sistemi funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt. Siguria në punë është prioriteti ynë kryesor.

Puna në nënstacion kërkon disiplinë, përgjegjësi dhe respektim të rreptë të rregullave të sigurisë. Vetëm në këtë mënyrë mund të kujdesemi si për njerëzit, ashtu edhe për sigurinë e sistemit elektroenergjetik", thotë Bogevi





Puna në një objekt të tillë sjell edhe një sërë sfidash, nga monitorimi i gjendjes teknike të pajisjeve, reagimi i shpejtë dhe i saktë, deri te përballimi i situatave të ndryshme në sistem. Në situata emergjente, gatishmëria dhe përvoja e ekipit të punonjësve vijnë në shprehje të plotë, pasi nga shpejtësia dhe reagimi i duhur varet ruajtja e stabilitetit të rrjetit.

Kujdesi për TS Kavadarci do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara parashikohet rikonstruksioni i çatisë dhe fasadës së

objektit, me çka do të përmirësohen më tej kushtet e punës dhe gjendja fizike e vetë objektit..

Më shumë se gjysmë shekulli pas vënies së saj në funksion, TS Kavadarci mbetet një pikë e rëndësishme në rrjetin elektroenergjetik. Historia e saj është një histori e zhvillimit të sistemit elektroenergjetik, nga një objekt që në vitin 1968 filloi si pikë kyçeje e HEC-it „Tikvesh“, deri te një objekt modern i pajisur me sisteme bashkëkohore të komandimit dhe mbrojtjes.

Ndërsa e ardhmja e sektorit elektroenergjetik, sipas drejtuesit të TS Kavadarci, kërkon gjenerata të reja inxhinierësh.

"U rekomandoj fuqishëm Inxhinierëve të rinj ta pranojnë sfidën për të punuar në një nënstacion transformatorik. Është një punë që kërkon njohuri, përgjegjësi dhe përmirësim të vazhdueshëm profesional, por njëkohësisht ofron mundësinë për të qenë pjesë e diçkaje të madhe dhe të rëndësishme – funksionimit të sigurt të sistemit elektroenergjetik", përfundon Bogevi..



GRATË NË ENERGJETIKË

25 VJET PËRKUSHTIM NDAJ ANALIZAVE LABORATORIKE DHE SIGURISË SË SISTEMIT

Intervistë me Olivera Stojanovska – Teknologe testuese në laboratorin e ShA MEPSO



Prej shumë vitesh jeni pjesë e laboratorit të MEPSO-s. Si ka ndryshuar puna juaj në laborator ndër vite dhe cilat janë ndryshimet më të mëdha që solli akreditimi?

Në laboratorin e MEPSO-s punoj tashmë 25 vjet. Fillimet e mia këtu ishin një përvojë e madhe, ndërsa pajisjet, për atë kohë, ishin shumë cilësore. Por kur dëshironi të punoni dhe të përmirësoheni vazhdimisht

profesionalisht, kjo paraqet një sfidë edhe më të madhe.

Me kalimin e viteve ndryshuan edhe kërkesat dhe mënyra e punës, ndërsa akreditimi solli një ndryshim të madh.

Me të fituam njohje ndërkombëtare, ndërsa shërbimet dhe certifikatat tona njihen edhe jashtë vendit. Kjo nënkupton besim më të madh nga klientët, përparësi konkurruese, punë të standardizuar dhe kontroll të vazhdueshëm të cilësisë

Laboratori është i vetmi laborator i akredituar i këtij lloji në vend. Çfarë do të thotë kjo në punën e përditshme dhe sa e rëndësishme është ruajtja e standardeve të larta?

Me vetë akreditimin, laboratori është ngritur në një nivel më të lartë profesional. Jemi të vetmit në vend, madje edhe më gjerë në rajon, të akredituar për këtë lloj testimesh, kryesisht për transformatorët dhe ndërprerësit tanë, por edhe për testime për palë të treta.

Pas funksionimit të sigurt të sistemit elektrotransmetues qëndron edhe puna që më së shpeshti mbetet jashtë vëmendjes së publikut: testimet laboratorike, analizat dhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së pajisjeve të tensionit të lartë.

Laboratori i MEPSO-s është laborator i vetëm i akredituar i këtij lloji në vend dhe ka një rol kyç në garantimin e sigurtisë dhe besueshmërisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

Në këtë edicion të rubrikës "Gratë në Energjetikë", bisedojmë me Olivera Stojanovskën, teknologje testuese në Shërbimin për materiale izoluese, e cila tashmë 25 vjet është pjesë e ekipit që kujdeset për cilësinë e testimeve dhe zbatimin e standardeve më të larta profesionale.

Ajo flet për rëndësinë e akreditimit, sfidat e përditshme në laborator dhe rolin e testimeve parandaluese në ruajtjen e një sistemi elektroenergjetik të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Kjo do të thotë se çdo ditë punojmë sipas standardeve të larta dhe procedurave të përcaktuara qartë.

Çfarë analizoni dhe çfarë mund të zbulojnë më së shpeshti këto analiza për gjendjen e pajisjeve elektroenergjetike?



Analizohen transformatorët tanë 400 kV përmes kontrolleve të rregullta, ndërsa sipas nevojës kryhen edhe testime të jashtëzakonshme. Kryhen analiza FHA dhe GHA, si dhe matet gazi SF₆ në ndërprerësit në të gjithë territorin e Maqedonisë. Nëse paraqiten parametra të palejueshëm, sipas nevojës kryhen matje të jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Këto analiza janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e gjendjes dhe cilësisë së pajisjeve elektroenergjetike, ndërsa mbi bazën e parametrave të fituar merren vendime për veprimet e mëtejshme.

Sa të rëndësishme janë testimet parandaluese për sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit të transmetimit?

Testimet parandaluese janë jashtëzakonisht të rëndësishme për funksionimin e pandërprerë të sistemit elektroenergjetik, sigurimin e cilësisë, parandalimin e defekteve dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

Punoni edhe me mostra të pajisjeve që janë në shfrytëzim. Sa kërkon kjo punë disiplinë, saktësi dhe koordinim të mirë me shërbimet e tjera në MEPSO?

Kjo punë kërkon tolerancë absolute zero ndaj gabimeve.

Vetë akreditimi na ka mundësuar saktësi më të madhe në gjithçka që bëjmë. Disiplina, respektimi dhe zbatimi i procedurave janë shumë të rëndësishme, ashtu si edhe saktësia e instrumenteve matëse. Diagnostikimi i hershëm dhe i saktë është pjesë e përditshmërisë sonë. Laboratori i MEPSO-s është një hallkë e rëndësishme në këtë zinxhir dhe për këtë arsye është i domosdoshëm koordinimi i përsosur me shërbimet e tjera, me qëllim ruajtjen e një sistemi elektroenergjetik të qëndrueshëm dhe të sigurt në vend.



Laboratori punon edhe për kompani të jashtme nga vendi dhe rajoni. Çfarë do të thotë për MEPSO-n kjo besueshmëri e treguar dhe si ndërtohet një reputacion i tillë?

Për MEPSO-n, fakti që laboratori ofron shërbime edhe për kompani të jashtme nga vendi dhe rajoni përfaqëson dëshminë më të lartë të cilësisë së njohur ndërkombëtarisht, epërsisë teknike dhe suksesit komercial. Në këtë mënyrë, MEPSO merr konfirmim për profesionalizmin dhe ekspertizën e saj. Për këtë jemi përgjegjës ne, punonjësit e laboratorit, përmes paanshmërisë, objektivitetit, shpejtësisë dhe efikasitetit në përmbushjen e kërkesave.





Teknologjia dhe standardet në energjetikë zhvillohen vazhdimisht. Si duket procesi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional në një laborator të akredituar?

Në laboratorin tonë të akredituar, i cili punon sipas standardit ndërkombëtar IEC 17025, procesi i zhvillimit profesional është i përcaktuar qartë, i planifikuar dhe i rishikuar në nivel vjetor. Ai mbështetet me trajnime, pajisje të reja, standarde të reja, kalibrimin e pajisjeve dhe certifikata për përdoruesit e autorizuar. Laboratori merr pjesë në skemat PI-TI, organizon trajnime të brendshme dhe zbaton vlerësime periodike të personelit, përkatësisht ri-vlerësime.



KCilat janë sfidat më të mëdha teknike që prisni në vitet e ardhshme, duke pasur parasysh tranzicionin energjetik dhe integrimin gjithnjë e më të madh të teknologjive të reja?

Sfidat më të mëdha teknike në vitet e ardhshme do të jenë ruajtja e stabilitetit të rrjetit, zhvillimi i mëtejshëm i laboratorit dhe zhvillimi investues. Kjo nënkupton pajisje të reja, teknologji të avancuara dhe përmirësimin e kapaciteteve për testime, me qëllim rritjen e mëtejshme të stabilitetit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike..

Çfarë përfaqëson për Ju kënaqësinë më të madhe profesionale?

Për mua, kënaqësia më e madhe profesionale është zgjidhja me sukses e problemeve komplekse. Më motivojnë efikasiteti në punë, mundësia për një qasje krijuese, qasja në informacione, trajnimet dhe pajisjet e reja, të gjitha me synimin për zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të laboratorit.



NJË DITË ME EKIPIET E DEPARTAMENTIT TË LINJAVETË TRANSMETIMIT

ATJE KU RRUGA PËRFUNDON, PUNA VAZHDON



Shkruan: Irina Daskallovska Qosevska

Mavrova dhe Galiçniku. Masive malore, pyje të dendura, shpate të thepisura dhe terrene ku nuk arrihet lehtë. Për shumicën e njerëzve, këto janë vende për pushim dhe shijim të natyrës.

Për ekipet e Departamentit të Linjave të Transmetimit pranë Njësisë OPM, këto janë vende ku punohet çdo ditë.

Së bashku me inxhinierin kryesor të Njësisë ORrT, Jane Gerasimovski, drejtuesin e Departamentit të Linjave të Transmetimit, Ardi Hamza, dhe ekipet në terren, kaluam një ditë pune duke ndjekur nga afër se çfarë do të thotë të kujdesesh për linjat e transmetimit dhe për sigurinë e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, në vende ku natyra jo rrallëherë vendos kushtet më të vështira. Dita fillon herët. Kontrollohet pajisja, përcaktohen detyrat, planifikohet lëvizja dhe qasja në lokacione. Në terren nuk ka hapësirë për nxitim, e aq më pak për improvizime. Çdo hap ka arsyen e vet, ndërsa siguria është kushti i parë para se të fillojë çdo ndërhyrje.



Kur te shtylla e linjës së transmetimit nuk të çon asnjë rrugë

Puna e ekipeve të linjave të transmetimit nuk zhvillohet vetëm pranë rrugëve. Një pjesë e madhe e traseve kalon nëpër zona malore dhe vështirë të qasshme, terrene të thepisura dhe pyje të dendura. Atje ku automjeti nuk mund të vazhdojë, ekipet përdorin katërçikleta të specializuara, me të cilat mund të arrijnë më lehtë te shtyllat e linjave të transmetimit.

Në disa vende nuk ka fare rrugë. E vetmja mënyrë për të arritur është përmes ujit, ndaj varka është pjesë e pajisjeve që i ndihmon ekipet të arrijnë te linjat e transmetimit, të kryejnë inspektime ose të ndërhyjnë kur është e nevojshme.

"Në terren, zakonisht nuk është problem detyra që duhet të përfundohet, por mënyra se si të arrijmë në vendin ku duhet ta kryejmë atë", thotë Jane Gerasimovski. "Prandaj është e rëndësishme të kemi pajisjet e duhura dhe ta planifikojmë mirë çdo hap."



Punë në lartësi mbi tokë

Një nga aktivitetet që ndoqem nga afër ishte zëvendësimi i izolatorëve në njërin nga shtyllat e linjës së transmetimit. Nga toka mund të duket si një punë rutinë, një ndërhyrje e thjeshtë, por lartësia në të cilën kryhet puna, kushtet dhe puna me pajisje të rrjetit të transmetimit kërkojnë përvojë, saktësi dhe respektim të rreptë të procedurave të sigurisë.

Pikërisht këto ndërhyrje janë pjesë e mirëmbajtjes parandaluese, me të cilën zgjatet jetëgjatësia e pajisjeve dhe sigurohet besueshmëria e rrjetit të transmetimit. Çdo izolator, çdo lidhje dhe çdo shtyllë kontrollohen me kujdes, sepse pikërisht këto aktivitete kontribuojnë në stabilitetin e të gjithë sistemit elektroenergjetik



"Kur diçka bëhet në kohë, zakonisht askush nuk e vëren se kemi parandaluar një problem", thotë Ardi Hamza. "Por pikërisht ky është qëllimi i mirëmbajtjes parandaluese: të mos presim që defekti të ndodhë, por ta parandalojmë atë."



Traseja duhet të jete e paster

Përveç shtyllave të linjave të transmetimit, po aq e rëndësishme është edhe traseja nëpër të cilën kalojnë përçuesit. Në terren takuam edhe ekipet që punojnë për pastrimin e trasesë. Heqja e degëve, pemëve dhe vegjetacionit të rritur që afrohet pranë përçuesve mund të krijojë probleme serioze, veçanërisht gjatë erërave të forta, stuhive ose reshjeve të borës. Prandaj, pastrimi i trasesë është një pjesë e rregullt dhe e domosdoshme e mirëmbajtjes së linjave të transmetimit, që kërkon koordinim të mirë, planifikim të kujdesshëm dhe, mbi të gjitha, respektim të rreptë të rregullave të sigurisë.





Dronët – aleat modern i ekipeve në terren

Zhvillimi i teknologjisë ka avancuar ndjeshëm proceset e inspektimit dhe monitorimit të linjave të transmetimit. Sot, ekipet në terren kanë dronin si aleat, një pajisje që deri para disa vitesh ishte e vështirë edhe të imagjinohej.

Departamenti i Linjave të Transmetimit disponon pajisje me dronë, ndërsa punonjësit që i përdorin ato kanë autorizimet dhe certifikatat përkatëse për pilotim. Nga ajri mund të kontrollohen pjesë të trasesë ku qasja është e vështirë, të zbulohen më shpejt dëmtimet e mundshme, të planifikohet më mirë ndërhyrja dhe të rritet siguria e ekipeve në terren.

Pamjet e marra me dron përbëjnë njëkohësisht një mjet të rëndësishëm për dokumentim, analizë dhe planifikim të aktiviteteve të ardhshme.



"Droni na ndihmon të shohim diçka për të cilën më parë duhej të shkonim në këmbë, ndonjëherë edhe për orë të tëra", shpjegon Ardi. "Kjo nuk do të thotë se ekipi në terren bëhet më pak i rëndësishëm. Përkundrazi, informacioni i mirë nga droni na ndihmon që njerëzit ta kryejnë punën më shpejt dhe më sigurt."



Puna nuk nderpritet as ne kushtet me te veshtira te motit

Puna e ekipeve të linjave të transmetimit nuk përfundon me motin e mirë. Në dimër, kur bora mbulon zonat malore, kur temperaturat bien nën zero dhe qasja në trase bëhet edhe më e vështirë, puna e tyre vazhdon. Fotografitë nga ndërhyrjet dimërore dëshmojnë për kushtet në të cilat çdo hap është i vështirë, por detyra mbetet e njëjtë: rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike të jetë i sigurt dhe stabil.





"Në terren, moti jo gjithmonë është në anën tonë. Ndonjëherë ka borë, ndonjëherë shi, ndonjëherë erëra të forta. Por, nëse e dimë se çfarë duhet të bëjmë dhe jemi të përgatitur mirë, edhe kushtet më të vështira mund të përballohen", thotë Gerasimovski.



Pas çdo shtylle të linjave të transmetimit qëndron një ekip

Pas disa orësh të kaluara në terren, bëhet më e qartë se sa shumë punë fshihet pas diçkaje që zakonisht e shohim vetëm si një shtyllë të linjës së transmetimit në largësi. Pas saj qëndron një njeri që e kontrollon, një ekip që ngjitet drejt saj në të gjitha kushtet e



motit, një koleg që monitoron gjendjen e trasesë dikush që me dron kontrollon terrenin, ndërsa pas të gjithë këtyre qëndrojnë punë e planifikuar mirë, profesionalizëm dhe përgjegjësi.

"Mund të kemi pajisje të mira dhe teknologji moderne, por në fund janë njerëzit ata që e kryejnë punën", thotë Nikola Nikolovski, drejtues i Ekipit të Linjave të Transmetimit – Shkup, Shërbimi për Mirëmbajtjen e Linjave të Transmetimit, Departamenti i Linjave të Transmetimit. "Ekipet tona e njohin terrenin, e dinë punën dhe e dinë se nuk ka vend për kompromis kur bëhet fjalë për sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit", shton ai.



Dhe pikërisht këtu, në malet mbi Mavrovë dhe Galičnik, ku rruga shpesh përfundon shumë përpara se të përfundojë traseja, bëhet e qartë se çfarë do të thotë kujdesi i përditshëm për rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike. Një punë që publiku nuk e sheh, por e ndien sa herë që energjia elektrike arrin në mënyrë të sigurt aty ku nevojitet.

BURIMET NJERËZORE

SHA MEPSO ME NJË SËRË AKTIVITETESH PËR ZHVILLIMIN E POTENCIALIT TË BURIMEVE NJERËZORE




Në një kohë kur sektori energjetik po ndryshon më shpejt se kurrë më parë, suksesi i një kompanie nuk varet vetëm nga teknologjia dhe infrastruktura, por mbi të gjitha nga njerëzit që i krijojnë, i menaxhojnë dhe i zhvillojnë këto procese. Duke u udhëhequr nga bindja se kapitali njerëzor është burimi më i vlefshëm i çdo kompanie të suksesshme, ShA MEPSO investon vazhdimisht në zhvillimin e punonjësve të saj, në forcimin e kulturës organizative dhe në krijimin e një sistemi modern dhe efikas për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Plani i Departamentit të burimeve njerëzore për vitin 2026 është i orientuar drejt krijimit të kushteve për zhvillim profesional, mësim të vazhdueshëm dhe forcim të kompetencave të punonjësve, paralelisht me sigurimin e mbështetjes efikase kadrovike dhe zbatimin konsekuent të legjislacionit në fuqi. Prioritet në periudhën e ardhshme mbetet aftësimi dhe avancimi profesional i punonjësve, pasi zhvillimi i shpejtë teknologjik, digjitalizimi i proceseve të punës dhe implementimi i sistemeve të reja informatike kërkojnë përditësim të vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive. Për këtë arsye, trajnimet planifikohen mbi bazën e nevojave reale të njësive

organizative dhe orientohen drejt zbatimit praktik të njohurive të fituara në punën e përditshme.

Departamenti i burimeve njerëzore punon gjithashtu në përmirësimin e mëtejshëm të sistemit për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e trajnimeve. Krahas realizimit të




tyre, vëmendje e veçantë i kushtohet matjes së efektivitetit, vlerësimit të përfitimeve për procesin e punës dhe nxitjes së transferimit të njohurive ndërmjet punonjësve. Qëllimi është që çdo trajnim i realizuar të krijojë vlerë të shtuar, jo vetëm për individin, por edhe për të gjithë sistemin organizativ.

Në mënyrë të vazhdueshme zhvillohen edhe aktivitete që lidhen me proceset e punësimit, administrimin e personelit, përmirësimin e sistematizimit të vendeve të punës, si dhe sigurimin e realizimit në kohë dhe me efikasitet të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga marrëdhënia e punës. Vëmendje e veçantë i kushtohet mbështetjes së praktikës profesionale, përmes së cilës ShA MEPSO u mundëson studentëve dhe nxënësve të fitojnë përvojë praktike dhe të njihen më mirë me

funksionimin e sistemit elektroenergjetik. Njëkohësisht, rëndësi e veçantë i jepet zhvillimit të kulturës së ndarjes së njohurive.


Punonjësit që marrin pjesë ose do të marrin pjesë në trajnime inkurajohen që përvojat dhe njohuritë e fituara t'i ndajnë me kolegët e tyre, duke e shndërruar mësimin individual në një vlerë të përbashkët dhe në një shtysë për zhvillimin organizativ.



"Përzgjedhja e kuadrove të duhura është zemra e funksionimit të Sha MEPSO në të ardhmen. Kuadro më cilësore do të thotë energji më e madhe potenciale, njohje më e mirë e profilit dhe cilësisë së personelit që kemi në dispozicion, punësim i punonjësve të rinj, përzgjedhje e duhur e vendeve të punës dhe, mbi të gjitha, realizim më efikas i objektivave strategjike të Sha MEPSO. Sa më cilësisht të realizohet ky funksion, aq më afër jemi arritjes së qëllimeve tona", thotë Zhaklina Lazarevska, udhëheqëse e Shërbimit për përzgjedhje, zhvillim profesional dhe planifikim në Departamentin e burimeve njerëzore.

Sipas saj, investimi i vazhdueshëm në njerëz përfaqëson një investim afatgjatë në të ardhmen e kompanisë.

Me objektiva të përcaktuara qartë, praktika bashkëkohore të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe një qasje strategjike ndaj zhvillimit profesional, Sha MEPSO krijon bazën për ndërtimin e ekipeve kompetente, të motivuara dhe të përgatitura, të cilat do të



përballojnë me sukses sfidat e tranzicionit energjetik dhe do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë. Në një botë ku dijet po bëhen kapitali më i çmuar, zhvillimi i potencialit njerëzor mbetet një nga investimet më të rëndësishme të Sha MEPSO – një investim që krijon vlerë sot, por edhe më shumë në të ardhmen.



TRANZICIONI ENERGJETIK NË EVJL: SFIDA TË REJA PËR STABILITETIN E SISTEMEVERE TË TRANSMETIMIT DHE ROLI I TEKNOLOGJIVE TË REJA

Shkruan: Elena Açkoska

Në kuadër të aktiviteteve profesionale të SHA
MEPSO u mbajt një prezantim me temën
“Tranzicioni energjetik në Evropën Juglindore –
sfida të reja për stabilitetin e sistemeve të
transmetimit dhe roli i teknologjive të reja”,
kushtuar ndryshimeve që sjell integrimi i
përsheptuar i burimeve të rinovueshme të
energjisë dhe ndikimit të tyre në funksionimin e
sistemeve elektroenergjetike. Prezantimi u
përqendrua në ndryshimet dinamike që sjell
tranzicioni energjetik dhe ndikimin e tyre në
funksionimin e sistemeve elektroenergjetike.

“Kur studioja, sistemi elektroenergjetik konsiderohej një nga disiplinat inxhinierike më të qëndrueshme. Sot, tranzicioni energjetik po i ndryshon rregullat me një shpejtësi të paparë”, theksova, duke vënë në dukje se sistemet moderne elektroenergjetike kërkojnë një qasje të re ndaj planifikimit, menaxhimit dhe koordinimit rajonal.


Vitet e fundit jemi dëshmitarë të një rritjeje intensive të burimeve të rinovueshme të energjisë, veçanërisht të centraleve fotovoltaike. Me më shumë se 1.500 MW kapacitet të burimeve të rinovueshme të integruara, sistemi elektroenergjetik maqedonas nuk përfaqëson më një sistem pasiv, por një nyje aktive rajonale.

Në kushte të tilla, roli i MEPSO-s bëhet edhe më i rëndësishëm, jo vetëm si operator i rrjetit të transmetimit, por edhe si koordinator i proceseve të sistemit, garantues i sigurisë dhe bartës i planifikimit afatgjatë dhe koordinimit rajonal



Integrimi i një numri të madh të burimeve të energjisë së rinovueshme (OIE) sjell edhe sfida të reja operative: flukse të ndryshueshme të fuqisë, nevoja të shtuara për energji balancuese, ulje të inercisë së sistemit dhe menaxhim gjithnjë e më kompleks të tensioneve dhe stabilitetit të sistemit. Vëmendje e veçantë iu kushtua problemit të tensioneve të larta gjatë regjimeve pranverore, të cilat sot përbëjnë një nga sfidat operative më aktuale në rajon. Si pjesë e aktiviteteve të MEPSO-s për përmirësimin e rregullimit të tensionit dhe sigurisë së sistemit, prezantova edhe instalimin e paralajmëruar të një reaktori shunt prej 150 MVAR në Nënstacionin Dubrovo. Në prezantim u theksua gjithashtu nevoja për një qasje të integruar në planifikimin dhe menaxhimin e rrjetit të transmetimit dhe atij të shpërndarjes.

Me rritjen e numrit të burimeve të rinovueshme, të dyja rrejetet po funksionojnë gjithnjë e më shumë si një sistem i vetëm, gjë që kërkon koordinim të vazhdueshëm, shkëmbim të të dhënave në kohë reale dhe marrje të përbashkët të vendimeve operative.



Në pjesën përmbyllëse u prezantua vizioni për sistemin elektroenergjetik të së ardhmes, në të cilin rol kyç do të kenë fleksibiliteti, sistemet e baterive, centralet virtuale, teknologjitë e avancuara EMS/SCADA dhe PMU, inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi. U theksua se siguria e ardhshme nuk do të varet vetëm nga ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, por edhe nga aftësia e sistemit për të reaguar shpejt, për t'u

koordinuar dhe për të menaxhuar proceset gjithnjë e më komplekse që sjell tranzicioni energjetik. Prezantimi edhe një herë konfirmoi rolin strategjik të MEPSO-s në procesin e tranzicionit energjetik dhe përkushtimin e tij ndaj zhvillimit të një sistemi elektroenergjetik modern, të sigurt dhe të integruar në nivel rajonal, të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

PPUNËTORI PËR INTEGRIMIN E BURIMEVE TË NDRYSHUESHME TË ENERGJISË SË RINOVUESHME

Në fund të korrikut u zhvillua një punëtori teknike në kuadër të projektit "North Macedonia: Supporting Smart Grid Infrastructure and Development to Facilitate Accelerated and Reliable Renewable Energy Sources (RES) Absorption", i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Gjatë punëtorisë u prezantuan rezultatet e vlerësimit të fleksibilitetit dhe adekuatshmërisë së sistemit elektroenergjetik, rezultatet paraprake të modelimit të dispeçimit dhe tregut, si dhe simulimet fillestare për Analizën Kosto-Përfitim (CBA) për projektet prioritare të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.



U trajtuan treguesit e sigurisë së furnizimit, nevojat për fleksibilitet dhe balancim, mundësitë për ruajtjen e energjisë, si dhe kufizimet e pritshme të prodhimit nga burimet e rinovueshme. Vëmendje e veçantë iu kushtua supozimeve kryesore të

modeleve dhe mënyrës se si rezultatet e përfituara do të kontribuojnë në vlerësimin e përfitimeve nga projektet potenciale për zhvillimin e rrjetit të transmetimit. Punëtorja mundësoi shkëmbimin e mendimeve dhe diskutime eksperte ndërmjet përfaqësuesve të MEPSO-s dhe konsorciumit të konsulentëve COLENCO-DNV, si dhe me përfaqësues të Ministrisë së Energjisë, me qëllim konfirmimin e supozimeve bazë dhe sigurimin e komenteve para finalizimit të Analizës së Kostove dhe Përfitimeve. Ky projekt synon të mbështesë modernizimin e rrjetit të transmetimit dhe të



krijojë kushte për integrim më të shpejtë, më të sigurt dhe më efikas të burimeve të energjisë së rinovueshme në sistemin elektroenergjetik të Maqedonisë, duke kontribuar në tranzicionin energjetik dhe në përmbushjen e objektivave kombëtare dhe evropiane në fushën e energjisë.

KOFERENCA, PREZENTIME, TRAJNIME

NJOHURI DHE AFTËSI TË REJA PËR TË PUNËSUARIT PËRMES **TRAJNIMIT PËR AI, MENAXHIM PROJEKTESH DHE MS PROJECT**



Me synim avancimin e kompetencave digjitale dhe forcimin e kapaciteteve për menaxhim të suksesshëm të projekteve, të punësuarit në MEPSO morën pjesë në një trajnim katërditor kushtuar inteligjencës artificiale, menaxhimit të projekteve dhe MS Project. Trajnimi, i organizuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) nga Kosova, u zhvillua nga 20 deri më 24 korrik 2026, me fokus në zbatimin praktik të mjeteve dhe metodologjive bashkëkohore në punën e përditshme. Pjesëmarrësit patën mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre mbi bazat e inteligjencës artificiale, mësimin makinerik (Machine Learning),



analizës dhe parashikimit, si dhe mbi mundësitë e përdorimit të AI në proceset institucionale dhe projektore. Gjithashtu, përmes ushtrimeve praktike, ata u njohën me parimet e menaxhimit të projekteve dhe përdorimin e MS Project për planifikimin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të projekteve. Kombinimi i ligjëratave teorike, demonstrimeve praktike dhe punës me shembuj konkretë u mundësoi pjesëmarrësve të fitojnë njohuri të zbatueshme, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të punës, planifikim më të mirë dhe realizim të suksesshëm të projekteve të ardhshme në MEPSO..

INXHINIERËT E MEPSO-S NË **TRAJNIM PROFESIONAL NË SEleNe CC**

Në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme për forcimin e bashkëpunimit operacional rajonal, inxhinierë të ShA MEPSO gjatë muajit korrik morën pjesë në një trajnim profesional në SEleNe CC. Trajnimi u organizua në dy grupe dhe ishte i përqendruar në zbatimin praktik të proceseve dhe mjeteve që përdoren në koordinimin e përditshëm operacional. Gjatë trajnimit u prezantuan proceset



që lidhen me analizën e koordinuar të sigurisë, përgatitjen dhe përpunimin e modelit të përbashkët të rrjetit, si dhe proceset për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me metodologjitë dhe rekomandimet e ENTSO-



E. Vëmendje e veçantë iu kushtua zbatimit praktik të proceseve, ku pjesëmarrësit punuan me skenarë realë dhe ushtrime praktike duke përdorur mjetet softuerike që ofron platforma e SEleNe CC. Ky trajnim përfaqëson një hap të rëndësishëm në avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet ShA MEPSO dhe SEleNe CC, duke mundësuar zbatim të harmonizuar të proceseve operative, shkëmbim të përvojave dhe forcim të kapaciteteve të stafit inxhinierik për koordinim efikas dhe të sigurt të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

KOFERENCA, PREZENTIME, TRAJNIME

NGA AUDITORI I FAKULTETIT NË QND: TEORIA MERR KUPITIM KUR E SHEH NGA AFËR RRJETIN E TRANSMETIMIT

Katër studentë nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjive Informative (FIETI), nga viti i dytë dhe i tretë i studimeve, po zhvillojnë këtë verë praktikën profesionale në MEPSO. Gjatë trajnimit disajavor, ata kanë mundësinë të njihen nga afër me funksionimin e sistemit elektrotransmetues të Maqedonisë së Veriut dhe me punën e shërbimeve që çdo ditë sigurojnë furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike.



Studentët vijnë nga programe të ndryshme studimore: Elektroenergjetikë, Automatizim dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (EABRE), Inxhinieri e Sistemeve Kompjuterike, Automatizim dhe Robotikë (ISKAR) dhe Teknologji dhe Inxhinieri Kompjuterike (TIK), gjë që u mundëson ta shohin funksionimin e MEPSO-s nga këndvështrime të ndryshme dhe të kuptojnë zbatimin praktik të njohurive të fituara në fakultet.



Gjatë praktikës ata vizituan Qendrën Nacionale Dispečerike, trafostacionet "Pintija" dhe "Butel", Shërbimin për AMR/MMR, shërbimet për planifikim dhe programim ditor (scheduling), menaxhim të balancimit, shërbimin për shkyçje, mbrojtje releore, si dhe laboratorin e akredituar të MEPSO-s. Në secilin lokacion, inxhinierët e MEPSO-s i njohën studentët me proceset, teknologjitë dhe përgjegjësitë që qëndrojnë pas çdo segmenti të menaxhimit të sistemit të transmetimit.



"Mbresën më të madhe ma lanë trafostacionet. Në fakultet mësojmë shumë gjëra në teori, por vetëm kur i sheh nga afër pajisjet, sistemet mbrojtëse dhe mënyrën se si funksionon një nënstacion, e gjithë pamja bëhet shumë më e qartë", tha Nikola. Për studentët ishte veçanërisht interesante që praktikisht e panë ndërlidhjen e të gjitha shërbimeve në MEPSO dhe se si çdo proces përbën pjesë të një sistemi kompleks, ku nuk ka vend për improvizim.

"Tani e kuptojmë shumë më mirë sa të rëndësishme janë matjet e sakta, planifikimi cilësor dhe koordinimi në kohë. Kuptuam se pas funksionimit të sigurt të sistemit elektroenergjetik qëndrojnë përgjegjësi e madhe dhe punë ekipore", tha Angela.

Përshtypje të veçantë tek ata la puna në Qendrën Nacinale Dispeçerike, ku, siç thonë, për herë të parë patën mundësinë të shohin se si monitorohet në kohë reale funksionimi i sistemit elektroenergjetik dhe si zhvillohet koordinimi me operatorët fqinjë të sistemeve të transmetimit.

"Në fakultet mësojmë për sistemet elektroenergjetike, por nuk kemi shumë mundësi të shohim në praktikë se si monitorohen rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike, interkoneksionet dhe koordinimi i përditshëm me shtetet e tjera. Ishte një përvojë krejtësisht e re për ne dhe na tregoi sa

kompleks është menaxhimi i një sistemi kombëtar të transmetimit", tha Leonidi.

Puna praktike, thonë studentët, i ndihmoi të lidhin më mirë njohuritë teorike me proceset reale inxhinierike, por edhe të vendosin standarde më të larta për zhvillimin e tyre të ardhshëm profesional. *"Pas kësaj praktike e dimë shumë më qartë se në çfarë mjedisi do të donim ta ndërtonim karrierën tonë. Pamë se si duket puna në një sistem ku çdo vendim është i rëndësishëm dhe ku profesionalizmi, disiplina dhe njohuritë janë parakushtet themelore", tha Miroslavi.*



Për MEPSO-n, praktika profesionale përfaqëson një investim në gjeneratat e ardhshme të inxhinierëve dhe një mundësi që studentët, që gjatë studimeve, të krijojnë një pasqyrë reale për punën e operatorit kombëtar të sistemit të transmetimit. Programet e tilla u mundësojnë atyre një kalim më të lehtë nga arsimi akademik në praktikën inxhinierike, ndërsa njëkohësisht i mundësojnë kompanisë të identifikojë dhe motivojë kuadrot e ardhshme profesionale, të cilët në të ardhmen do të jenë pjesë e zhvillimit dhe funksionimit të sigurt të sistemit elektroenergjetik të Maqedonisë së Veriut.

SINDIKATA E SHA MEPSO U PREZANTUA ME SUKSES NË TAKIMET E XIII

RAJONALE SPORTIVE NË KLADOVË



Në organizim të sindikatave të kompanive të transmetimit të energjisë elektrike nga Evropa Juglindore, nga 11 deri më 14 qershor 2026, në Kladovë, Republika e Serbisë, u mbajtën Takimet e XIII rajonale sportive, ku mori pjesë edhe Sindikata e ShA MEPSO me një delegacion prej 80 pjesëmarrësish. Këto takime tradicionale sportive, që organizohen prej më shumë se një dekade, bashkojnë punonjësit e kompanive elektroenergjetike nga rajoni, duke krijuar mundësi për shoqërim, bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash.

Në ceremoninë solemne të hapjes, të mbajtur në hotelin "Gjerdap", organizatorët dhe përfaqësuesit e organizatave sindikale nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut theksuan se sporti i bashkon njerëzit përmes frymës së lojës së ndershme (fair play), punës




ekipore dhe solidaritetit – vlera që sindikatat i kultivojnë edhe në veprimtarinë e tyre të përditshme. Gjatë takimeve sportive, garuesit u përballën në disa disiplina sportive:

Gjatë takimeve sportive, garuesit u përballën në disa disiplina sportive:

- volejbol,
- basketboll 3x3,
- bowling,
- tenis,
- not,
- shah,
- shigjeta
- pingpong,





Ekipet tona garuan me motivim të lartë, frymë sportive dhe respekt për rregullat e lojës së ndershme, duke përfaqësuar me dinjitet ShA MEPSO dhe Maqedoninë e Veriut. Përveç pjesës garuese, këto takime mundësuan krijimin e miqësive të reja, shkëmbimin e përvojave dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave sindikale të rajonit

. Me pjesëmarrjen në këto lojëra sportive, Sindikata dëshmoi se, krahas mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, i kushton rëndësi edhe rekreacionit, shëndetit dhe forcimit të frymës

ekipore të anëtarëve të saj. Përveç pjesëmarrjes në takimet sportive, periudha e kaluar ishte e rëndësishme edhe në planin sindikal. Pas një dialogu konstruktiv social me menaxhmentin,

Sindikata siguroi rritjen e pagave prej 8,3%, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë ekonomike dhe standardit të jetesës së punonjësve. Në funksion të përmirësimit të mbrojtjes shëndetësore të punonjësve, Sindikata planifikon që gjatë muajit nëntor të organizojë pushime parandaluese për punonjësit që punojnë në kushte të rënda dhe specifike pune.

Një sindikatë e fortë do të thotë një punëtor i sigurt. Së bashku vazhdojmë të ndërtojmë një mjedis pune më të mirë dhe një MEPSO më të fortë.

PUNONJËSIT DHE MEPSO

Pançe Manojllovski ka diplomuar në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, ndërsa në vitin 2015 ka përfunduar studimet master në programin e Marketingut. Në ShA MEPSO është i punësuar që nga viti 2008, kur e filloi karrierën e tij në TS Jegunovcë. Më pas punoi në Departamentin e kontabilitetit, ndërsa nga viti 2010 është pjesë e Departamentit të Çështjeve Komerciale. Në vitin 2020 u emërua udhëheqës i Shërbimit për prokurime komerciale, ndërsa nga viti 2023 udhëheq Departamentin e çështjeve komerciale në Sektorin e Çështjeve Financiare. Ai posedon certifikatë si person i autorizuar për prokurime publike, si dhe një numër të madh certifikatash nga fusha e prokurimeve publike, duke përmirësuar vazhdimisht njohuritë dhe kompetencat e tij profesionale. Është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e punës në Departament, duke siguruar realizimin në kohë dhe me efikasitet të programeve, planeve dhe nevojave për prokurime dhe shitje në ShA MEPSO. Njëkohësisht ushtron mbikëqyrje dhe kontroll mbi zbatimin e procedurave të prokurimeve publike, duke u kujdesur për ligjshmërinë, transparencën dhe efikasitetin e tyre. Me përvojën e tij shumëvjeçare dhe njohuritë në fushën e prokurimeve publike, ai merr pjesë aktive në përgatitjen dhe realizimin e një numri të madh procedurash me rëndësi strategjike për kompaninë.




Aleksandra Agovska është magjistre e inxhinierisë elektrike me 18 vjet përvojë pune në sektorin energjetik. Karrierën e saj e filloi në vitin 2008 në sektorin privat si inxhinier e sistemeve SCADA, ku përmes angazhimit në projekte industriale dhe infrastrukturore ndërtoi një bazë të fortë njohurish në projektimin dhe implementimin e zgjidhjeve SCADA. Në ShA MEPSO u punësua në vitin 2014, ku ka ushtruar disa funksione – dispeçere operative, inxhinier e sistemeve SCADA dhe inxhinier për mirëmbajtjen e sistemit të matjes së energjisë elektrike – duke e zgjeruar vazhdimisht njohjen e saj mbi funksionimin operativ të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Aktualisht punon në Shërbimin për kycje, ku është pjesë e ekipit që koordinon procesin e kycjes së objekteve elektroenergjetike në rrjetin elektrotransmetues duke zbatuar legjislacionin përkatës energjetik dhe aktet nënligjore.

Ardi Hamza është magjistër i inxhinierisë elektrike dhe udhëheqës i Departamentit të largpërçuesve në Njësinë ORT. Në kuadër të këtij departamenti planifikohen, koordinohen dhe realizohen aktivitetet që lidhen me mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit 110 kV dhe 400 kV. Në cilësinë e udhëheqësit të departamentit, Ardi merr pjesë aktive në planifikimin, koordinimin dhe realizimin e projekteve të rëndësishme investuese. Ndër to janë ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kV TS Manastir 2 – Shqipëri, projekti për forcimin e rrjetit të transmetimit në pjesën juglindore të vendit, si dhe rikonstruksioni i linjave të transmetimit në aksin TS Gostivar – TS Oslomej – TS Kërçovë – TS Sopotnicë – TS Manastir. Një fokus i veçantë i punës së tij është modernizimi i sistemit elektrotransmetues përmes zbatimit të teknologjive bashkëkohore dhe zgjidhjeve inovative inxhinierike. Aktualisht po zhvillohen përgatitjet për implementimin e sistemit Dynamic Line Rating (DLR) dhe instalimin e përçuesve HTLS (High Temperature Low Sag) gjatë rikonstruksionit të linjave ekzistuese të transmetimit. Për inspektimin dhe mirëmbajtjen e rregullt të linjave të transmetimit përdoren teknologji moderne, duke përfshirë mjete ajrore pa pilot (dronë) të pajisur me kamera termografike dhe kamera me rezolucion të lartë. Kjo qasje mundëson identifikim të shpejtë dhe të saktë të defekteve të mundshme, rrit sigurinë gjatë inspektimeve dhe përmirëson efikasitetin e mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit. *детекција на потекцијални дефекти, поголема безбедност при инспекциите и поефикасно одржување на преносната мрежа.*



Dionis Tanaskoski është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, me arsim të lartë të përfunduar në Fakultetin Elektroteknik pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup. Karrierën e tij profesionale e fillon në kompani për projektim dhe realizim të objekteve dhe instalimeve elektroenergjetike, ndër të cilat „Dio Inxhiniering“ DOOEL Shkup dhe „LDL Inxhiniering“ DOO Shkup, ku ushtron disa funksione profesionale dhe drejtuese. Në vitin 2018 punësohet në SHA MEPSO, ku punon edhe sot. Në kuadër të Shërbimit për Planifikim Operativ, Departamentit për Operacione të Tregut, në kuadër të Njesisë së Operimit të Sistemit Elektroenergjetik (OES), ushtron funksionin e inxhinierit përgjegjës për planifikimin ditor. Gjatë punës së tij, ai kontribuon aktivisht në zhvillimin e kuadrove profesionale, ndërsa njohuritë dhe përvojën e tij profesionale i përcjell me sukses edhe si mentor për mësimin praktik. Posedon licenca të kategorisë B për projektim dhe realizim në fushën e elektroteknikës dhe është anëtar aktiv i Dhomës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në mënyrë të vazhdueshme e zhvillon kompetencën e tij profesionale përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe seminare, me fokus të veçantë në aspektet dhe praktikatat bashkëkohore në sektorin elektroenergjetik.



Ana Destanoviq është e diplomuar në Shkenca Politike në American College Shkup, ndërsa një pjesë të studimeve të larta e ka vazhduar në Vesalius College në Bruksel, Belgjikë, ku ka përfunduar vitin e fundit të studimeve. Në vitin 2015 ka fituar titullin Master në marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci. Prej 10 vitesh është pjesë e SHA MEPSO, ku angazhimin e saj profesional e ka filluar në Kabinetin e drejtorit gjeneral si referente në Shërbimin për organet e menaxhimit. Sot punon si referente përgjegjëse në Shërbimin për seleksionim, zhvillim profesional dhe planifikim, ku merr pjesë aktive në proceset e planifikimit të burimeve njerëzore, rekrutimit dhe përzgjedhjes së kuadrove, si dhe në organizimin dhe koordinimin e trajnimeve vendore dhe ndërkombëtare. Si përfaqësuese e SHA MEPSO në Legal and Regulatory Group (LRG) pranë ENTSO-E, ajo merr pjesë rregullisht në takime dhe aktivitete, duke ndjekur proceset

aktuale rregullatore evropiane dhe duke shkëmbyer përvoja me përfaqësues të operatorëve të sistemeve të transmetimit të energjisë elektrike nga më shumë se 30 vende evropiane anëtare të ENTSO-E. Në vitin 2025, ajo u bë përfaqësuesja e parë e SHA MEPSO që mori pjesë në HR TSO Community Seminar, të organizuar nga ENTSO-E

Vojne Saveski është teknik përgjegjës në Sektorin e IT/TK-së, Departamentin e Telekomunikacionit. Ka 30 vjet përvojë pune, të cilën e fillon në vitin 1995 në atë kohë në ESM. Karrierën e tij profesionale e fillon si elektroteknik në laboratorin e kalibrimin në Elektrodistribucionin e Shkupit, në periudhën kur filloi futja dhe testimi i matësve të parë digjitalë të energjisë elektrike. Në të njëjtin vit, rrugëtimin e tij profesional e vazhdon në Shërbimin e Telekomunikacionit, në Departamentin e Rrjetit Radio. Në atë periudhë fillon edhe realizimi i një projekti të ri për digjitalizimin e sistemit të telekomunikacionit, i cili deri atëherë përdorte përcësuesit e fazës si mediume për transmetim. Nga viti 2005, me themelimin e SHA MEPSO, përvojën e tij të punës e vazhdon në Departamentin e Telekomunikacionit në Sektorin e IT/TK-së. Si pjesë e ekipit, ai merr pjesë në avancimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemeve të telekomunikacionit, si dhe në implementimin e teknologjive të reja. Ai merr pjesë aktive në realizimin e disa projekteve të rëndësishme, duke kontribuar me njohuritë, përvojën dhe përkushtimin e tij ndaj punës, bashkëpunimit në ekip, ndjekjes së arritjeve bashkëkohore teknologjike dhe integritet të tyre në drejtim të modernizimit, sigurisë dhe zhvillimit të infrastrukturës së telekomunikacionit të SHA MEPSO





OPERATOR I SISTEMIT
ELEKTROTRANSMETUES
Rr. Maksim Gorki nr. 4, 1000 Shkup



WWW.MEPSO.COM.MK

